

VENDIM
Nr.403, datë 19.6.2004

**PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIT TË KOMITETIT SHTETËROR PËR
PLANIFIKIMIN SPITALOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komitetit Shtetëror për Planifikimin Spitalor, si organ këshillimor pranë Ministrit të Shëndetësisë.

2. Komiteti Shtetëror për Planifikimin Spitalor miratohet nga Ministri i Shëndetësisë për një periudhë 3-vjeçare dhe në përbërje ka 11 anëtarë, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|----------|
| - Tre ekspertë të shquar në fushën e kujdesit spitalor | anëtarë; |
| - Një përfaqësues nga sindikata më e madhe e punonjësve të shëndetësisë | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Ministria e Financave | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Fakulteti i Mjekësisë | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Fakulteti i Infermierisë, Tiranë | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Urdhri i Mjekut | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga shoqatat e pacientëve | anëtar; |

3. Sekretari i këtij komiteti të jetë drejtori i Drejtorisë Spitalore në Ministrinë e Shëndetësisë.

4. Kryetari dhe nënkryetari i komitetit zgjidhen nga anëtarët e këtij komiteti në mbledhjen e parë, me shumicë votash.

5. Kryetari thërret mbledhjen e komitetit dhe është përgjegjës për përgatitjen e rendit të ditës e të materialeve të mbledhjeve, si dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së komitetit.

Kryetari brenda 6-mujorit të parë të vitit të parë, të periudhës 3-vjeçare të veprimtarisë së këtij komiteti i paraqet Ministrit të Shëndetësisë planin kombëtar spitalor për këtë periudhë, në përputhje me përparësitë e politikave në fushën e shëndetësisë, me të dhënat e qarqeve e buxhetet në dispozicion dhe me përcaktimet e bëra në nenin 41 “Plani shtetëror spitalor” të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

6. Vendimet e komitetit merren me shumicën e votave të numrit të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

7. Komiteti Shtetëror për Planifikimin Spitalor mblidhet të paktën 4 herë në vit.

8. Anëtarët dhe sekretari shpërblehen me 5000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje.

9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano